



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"  
Bordi i Administrimit

Nr. 3908 Prot.

Shkodër, më 08 . 11 .2019

**V E N D I M**

Nr. 360, datë 08 / 11 .2019

**“PËR MIRATIMIN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË  
PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË,  
PËR VITIN AKADEMIK 2019 – 2020 “**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3/ç, neni 6 pika 30, neni 38, 49; Ligjit nr. 99/2018, datë 03.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”; VKM-së nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, (i ndryshuar me VKM nr. 723, datë 06.12.2018, si dhe VKM nr 778, datë 26.12.2018); Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Statutit të USH-së i vitit 2018, neni 5, neni 17, pika 6/nj; neni 28, si dhe vendimit të Senatit Akademik nr. 253, datë 17.07.2019, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 08.11.2019, i cili mori në rishqyrtim pikën 7 të këtij vendimi në lidhje me tarifën e krediteve të lëndëve të palikuiduara, për studentët përsëritës të ciklit të dytë,

**Vendosi:**

1. Studentët e ciklit të dytë, që sipas Rregullores së USH-së, cilësohen si përsëritës, të paguajnë kreditet e lëndëve të palikuiduara, duke përjashtuar tarifën e krediteve të diplomës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

Namik **KOPLIKU**

